

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Fatos Qerimi, Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave MAPL	Datë: 23/01 /2018 Nr. 020-78
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Suharekës	
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim	


I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr. 112-2169 për themelimin, numrin dhe përbërjen e komiteteve të përhershme në Komunën së Suharekës
I miratuar më datë: 15.01.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 17.01.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të komunës së lart cekur, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Bali Muharremaj, gradonačelnik Opštine Suva Reka Bexhet Kuçi, predsedavajući Skupštine opštine Suva Reka	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Fatos Qerimi, direktor odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština /MALS	Datum: 23/01/2018
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Suva Reka	Br. 020-78
Vrsta odluke:	<input type="checkbox"/> Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opština i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 112-2169 za osnivanje, broj i sastav stalnih odbora u opštini Suva Reka
Usvojena dana, 15.01.2018. godine,
Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 17.01.2018. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je sa proceduralnog aspekta isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY-SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



TYREBE-GLAZNA-INCOPI
 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO

Shërbimi dhe Administrimi të Pushtetit Lokal
 Lokalne Samouprave i Administrimit
 of Local Government Administration

17-01-2018

Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenin 51, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenin 29 dhe 39 të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, nenit 4 lidhur me nenin 7 dhe 9, të Udhëzimit Administrativ (MAPI) Nr.03/2014, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 15.01.2018, miratoj këtë:

Numri i Aktit	Nr i Lëndës	Shtetja	Vlera
V-	020-78		

V E N D I M

Për themelimin e komiteteve të përhershëm.

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës në Suharekë, themelon komitetet e përhershëm dhe përcakton numrin e anëtarëve si më poshtë:

1. Komitetin për politik dhe financa dhe do të ketë----7, (shtatë) ulëse-anëtarë
2. Komitetin për Komunitete dhe do të ketë-----7, (shtatë) ulëse-anëtarë

Neni 2

2.1 Përbërja e Komitetit për politik dhe financa, duhet të reflektoj përfaqësimin e entiteteve politike si dhe numrin e ulësve nga entitetet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës.

2.2 Përbërja e Komitetit për Komunitete duhet të jetë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë jashtë tije.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të përhershme, janë të përcaktuara me Ligjin Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), dhe Statutin e Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008 dhe aktet tjera Ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr-112-2169
 Me datë 16.01.2018


Anëtar i më i vjetër i Kuvendit

 Salih BITYCI





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA-THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



16-01-2018

№	Uniti	Sh. N.	Adresa
01-1757			Suhareka

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

PËR/ZAFER:	Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në Prishtinë
CC:	Departamentit Ligjor të MAPL-ës
NGA/OP/FROM:	Shefi i Shërbimit të Kuvendit & Zyrtari Ligjor në Komunën e Suharekës
LËNDA/SUBJEKTI/SUBJECT:	Akt përcjellës
DATE/A:	16 janar 2018

HYRËSE - ULAZINA - INCORPORATED
 REPUBLICAN E KOSOVËS REPUBLICAN E KOSOVA, REPUBLIC OF KOSOVA
 OVEKUA E KOSOVËS VLAKA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministry of Local Government Administration

17.01.2018

Te nderuar,

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim aktet normative të miratuara nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, nga një kopje të vendimeve ju dërgojmë për shqyrtim të ligjshmërisë konform nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008").

Lista e akteve të cekura më lartë:

Nr.	Emri i Rregullores apo i Vendimit	Data e Miratimit
1.	Vendim për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës në Suharekë.	15.01.2018
2.	Vendimi për themelimin e komiteteve të përhershëm.	15.01.2018
3.	Vendimi për emërimin dhe plotësimin Komiteti për Politikë dhe Financa me anëtarë	15.01.2018
4.	Vendim për emërimin dhe plotësimin e Komiteti për Komunitete me anëtarë	15.01.2018

Andaj kërkojmë nga ju që konform nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale dhe nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, të bëni shqyrtimin e ligjshmërisë dhe në afat sa më të shkurtë të na ktheni përgjigje me shkrim lidhur me ligjshmërinë e këtyre akteve normative.

Me respekt,

Shefi i Shërbimit të Kuvendit
 & Zyrtar Ligjor
 Avni BYTYÇI

Kopje:
 MAPL-ës
 Arkivës